KËRKESË
Nr. 609/9, datë 29.5.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Zgjerim i rrugës Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë (faza VIII)'".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "truall", bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", si dhe për pasuritë e llojit "ndërtesë", bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është prej 32,491,879.7 (tridhjetë e dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë 7) lekësh.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I SEGMENTIT RRUGOR ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË, FAZA VIII"

Nr.	PRONARI					TË DHËNA (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT "ARË"			VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT "TRUALL"			VLERËSIMET PËR OBJEKTET E BANIMIT			Preventivi	Vlera totale	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa e pasurisë	Rrethi	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	SIPËRFAQE TOTALE	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)			
1	Shkelqim	Hajdar	Çepi	VULÇAN	LIBRAZHD	3843	396-ND1	Ndërtesë	116.8							116.8	32,695.0	3,818,776.0		3,818,776.0	Godinë banimi 1-katëshe, sip. banimi = 116.8 m^2
	Donika	Hajredin	Çepi																		
2	Alma	Beqir	Sina	VEHÇAN	LIBRAZHD	3725	267/7-ND3	Ndërtesë	165							405.5	32,695.0	13,257,822.5	6,050,427.0	19,308,249.5	Kati përdhes soc.-eko. = 165 m^2, kati 1 banimi = 240 m^2, kati 2 banimi = 165.5 m^2
	Eduart	Selim	Sina																		
3	Ismet	Xhaferr	Stafa	VULÇAN	LIBRAZHD	3843	397/3	Truall	261.3				261.3	154.0	40,240.2	139.9	32,695.0	4,574,030.5		4,614,270.7	Sip. banimi kati nëntokë = 52.8 m^2, sip. banimi kati përdhes 87.1 m^2
	Trandafile	Isak	Stafa																		
4	Dashamir	Hajdar	Çepi	VULÇAN	LIBRAZHD	3843	396-ND	Ndërtesë	145.3							145.3	32,695.0	4,750,583.5		4,750,583.5	Godinë banimi 1 katëshe, sip. banimi = 145.3 m^2
	Bukurie	Hajdar	Kryemadhi																		
	Antoneta	Hajdar	Xoxa																		
	Shkelqim	Hajdar	Çepi																		
	Luljeta	Hajdar	Hoxha																		
	Shuma paraprake																			32,491,879.7	